



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 36

Datë: 30. 04. 2021. Ora: 11:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Sami Hamiti, kryesues i mbledhjes së KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Artan Asllani.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Sami Hamiti, kryesues i mbledhjes së KQZ-së:
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të KQZ-së Nr.35/2021
3. Aktivitetet e SKQZ-së:
4. Aktivitetet e ZRPP-së:
5. Raporti i Këshillave të KQZ-së:

- Këshilli për Operacione Zgjedhore;

-Shqyrtimi i Raportit të Punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2020,

-Shqyrtimi dhe miratimi i specifikimeve teknike për shtypjen e fletëvotimeve dhe broshurave për Zgjedhjet Lokale 2021,

- **Këshilli për Buxhet dhe Financa**

-Shqyrtim dhe miratimi i kërkesës për transfer në programin e zgjedhjeve nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në shpenzime komunale;

-Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për ndarje të re buxhetore -buxhet shtesë në Program të Zgjedhjeve – në kategorinë e shpenzimeve kapitale për souftverin e QNR-së për Zgjedhjet Lokale 2021.

6. Të ndryshme

1. Hyrje: z. Sami Hamiti, kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Sami Hamiti: Me autorizimin e kryetares, në mungesë të saj këtë mbledhje e kryesoj unë...A ka dikush ndonjë propozim...?

Miratohet rendi i ditës, dhe po ashtu edhe procesverbali nga mbledhja e KQZ-së, nr.35/2021.

2. Aktivitetet e SKQZ-së:

Në vazhdim të mbledhjes, kryeshefi Burim Ahmetaj, i ka paraqitur në vija të shkurtëra aktivitetet e Sekretariatit, siq janë: përgatitja e draft raportit të Punës së KQZ-së për vitin 2020; Specifikat për asgjësimin/shkatërrimin e fletëvotimeve dhe materialit zgjedhor të zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës që janë mbajtur me 14 shkurt 2021; Aktivitetet lidhur me tjetërsimin e pasurisë jo financiare të KQZ-së të cilat, janë në proces e sipër, së bashku me formimin e dy komisioneve të cilat kanë për detyrë përgatitjen e specifikave: njëri komision ka të bëjë me identifikimin dhe krahasimin në Sekretariat të kartelës së punëtorit (stafit), gjendjes së inventarizimit dhe barazimin të këtyre dy listave duke përfshirë gjendjen faktike të artikujve që janë në shfrytëzim nga punëtori (stafi), kurse komisioni tjetër është formuar lidhur me përgatitjen e specifikave për materialet anti COVID-19, materiale të cilat do të përdoren në zgjedhjet Lokale të cilat do të mbahen në vjeshtën e këtij viti.

Sekretariati, përgjatë aktiviteteve ka draftuar raportin tre (3) mujor të aktiviteteve të Sekretariati për raportim në KQZ (pavarësisht që nuk ka ende plan të punës të miratuar për vitin 2021), dhe ku përfshihen të gjitha aktivitetet gjatë periudhës janar – mars 2021, përfshirë edhe aktivitetet për organizimin e zgjedhjeve që janë mbajtur me 14 shkurt 2021.

Në kuadër të aktiviteteve, z. Ahmetaj ka theksuar se është duke u përgatitur edhe raporti për vëzhgimin e zgjedhjeve nga KQZ në Republikën e Shqipërisë të mbajtura më 25 prill 2021. E po ashtu, më kuadër të përgatitjeve për procesin e zgjedhjeve të rregullta Lokale të cilat do të mbahen në vjeshtën e këtij viti, janë nisur procedurat e tenderimit të projektit të Informimit Publik, ndërsa në pritje është iniciimi i procesit të shtypjes dhe printimit të fletëvotimeve.

Gjithashtu, është duke u rishikuar buxheti i planifikuar nga secili departament dhe, analizimi i shpenzimeve të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës që janë mbajtur me 14 shkurt 2021.

Në fund, Ahmetaj i ka informuar anëtarët e KQZ-së se Zyra Kombëtare e Auditimit, është në procesin e Auditimit për vitin 2020, dhe se ka filluar nga data 29.04.2021.

Sami Hamiti: Z. Rama e ka ngritur çështjen e një dezinfektuesi, a është ndërmarrë diçka me pa në atë kontratë ? S'i është puna, se më duket shqetësuese. A është analizue kjo punë ?

Burim Ahmetaj: Sekretariati është duke u shqyrtuar, dhe në mbledhjen e radhës do të raportojmë...

Alim Rama: Unë, kisha kërkuar auditimin e brendshëm të këtij procesi...!

Sami Hamiti: Unë, kisha kërkuar formimin e një komisioni nga Sekretariati dhe të shihet çka ka ndodhur...!

Arianit Elshani: Një raport, është mirë ta kemi.

Sami Kurteshi: Kam folur edhe më parë, na e sjellin një mostër për me pa, dhe me e ditë se për çka është fjala...

3. Aktivitetet e ZRPP-së:

Yll Buleshkaj: Ua kemi dërguar një raport për disa nga punë tona s'i zyre, në mes të dy takimeve të KQZ-së! Disa nga aktivitetet kryesore kanë të bëjnë me shqyrtimin e dy iniciativave politike për regjistrim: Ajo e regjistrimit të partisë politike 'Iniciativa Balli' dhe, një iniciativë e komunitetit boshnjak! Pas pranimit të gjeturave nga zyra në draft Statutin dhe draft Programin e "Ballit", si dhe e mungesës së nënshkrimeve të përkrahësve, përfaqësuesit e kësaj iniciative kanë dorëzuar plotësimet e kërkuara. Aplikacioni i kësaj iniciative, do të del në shqyrtim publik nga 3, deri 10 maj 2021.

Gjithashtu, zyra ka pranuar aplikacionin e plotë të iniciativës për regjistrim të partisë politike boshnjake me emrin 'Bošnjačka Stranka' nga Peja. Brenda afatit ligjor, tha z. Buleshkaj, zyra do përgatis të gjeturat e veta dhe do ia dorëzoj përfaqësuesit të kësaj iniciative.

Çështje tjetër, ka qenë edhe auditimi i Raporteve Financiare dhe i Fushatës të subjekteve politik. Zyra javën e kaluar, e ka përfunduar raportin e gjendjes së "raporteve vjetore financiare dhe atyre të fushatës" të cilat raporte, ende nuk janë audituar (2018-2020). Z. Buleshkaj, ka shpjeguar për anëtarët e KQZ-së gjithë "relacionin" mes Zyrës dhe Administratës së Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrje të Financave Publike: bashkëpunimin e dy palëve lidhur me auditimin e subjekteve politike, e që Kuvendi është në përgatitje të specifikave për tenderim të këtij procesi.

Po ashtu, në raport me ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve profesionale të Zyrës përmes shkëmbimit të përvojave me institucione ndërkombëtare, z. Buleshkaj tha se drejtori Ekzekutiv i Zyrës, ka marr pjesë në Webinarin (Konferencën ndërkombëtare të organizuar online) "Abuzimi i Burimeve Shtetërore: Rreziqet dhe Zgjidhjet" (Ang. "Abuse of State Resources: Risks and Solutions.") e organizuar nga Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore (IFES). Diskutimi është zhvilluar nga ekspert të me IFES-t dhe nga Evropa e Rajoni (Britani e Madhe, Maqedoni e Veriut dhe Serbi), ku u theksua që abuzimi i burimeve shtetërore është treguar të jetë një forcë e madhe korruptive në shumë procese zgjedhore, pasi fut ose përkeqëson pabarazitë e pushtetit dhe u jep një avantazh të padrejtë elektoral funksionarëve në detyrë.

Zyra, sic tha në raportin e tij Buleshkaj, ka pranuar një kërkesa dhe përgatitur vërtetim bazuar në të dhënat që i posedon, duke përfshirë edhe arkivin e vet, për përfaqësues të një partie politike.

Sami Kurteshi: Unë, po e ngris një çështje që s'ka të bëj me këtë raportim! Kam marrë një mesazh prej Diasporës, sepse ata kanë shprehur dyshime, kurse ne e kemi c'regjistruar një parti që, më duket është "Partia Demokratike e Diapsores". Pra, ne duhet të jemi transparent deri në fund, mos me lanë asnjë dyshim...

Yll Buleshkaj: Po, ne i kemi informuar detajisht...

Rreth autidimit të subjekteve politike, përgjegjesisë audituese, diskutuan: Sami Hamiti dhe Eshref Vishi .

4.Raporti i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Operacione Zgjedhore:

1. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2020:

Alim Rama: Në këshill, e kemi shqyrtuar raportin e KQZ-së. Në parim, ne e kemi rekomandua për miratim. Por, drafti që prezantohet këtu, është me plotësime. Afati i dorëzimit është sot, por ne duhet të diskutojmë...

Sami Kurteshi: E kam lexua raportin. Kam një varg vërejtjesh ! Mendoj që është raport përshkrues, deskriptiv. Kurse ne, kemi diskutuar që të nxjerrën ato që kanë qenë çështje problematike, dhe të jepen edhe rekomandime...

Ne, tha z. Kurteshi, kemi mundësi të nxjerrim rekomandime. Por, unë kam vërejtje edhe me gjuhën, edhe me strukturën e raportit... ! Ai, dha vërejtje në pikën B. (fq.10) lidhur me formulimet, përmbajtjet, cilësimet etj., pastaj pika C... Vërejtje bëri po ashtu, edhe në fq. 11 lidhur me formulimin e përbërjes së KQZ-së, lidhur me Këshillat e KQZ-së, ku nuk tregohet asgjë se çka kanë bërë këshillat...

Z. Kurteshi, bëri vërejtje edhe me mos formimin e komitetit të auditimit, me punën e këshillit për marrëdhënie me jashtë...

Gjuhësisht, po ashtu, raporti ka vërejtje gjë që, po përcillet kjo nga raportet e kaluara.

Z. Kurteshi, zbërtheu edhe vërejtje të tjera brenda përmbajtjes së raportit, duke kërkuar që raporti të ketë standarde...

Në fund, z. Kurteshi bëri vërejtje edhe rreth rekomandimeve: formulimi i tyre dhe, mbështetja e tyre në përmbajtjen e raportit...

Alim Rama, dha vërejtje në fq. 25, rreth formulimit lidhur me raportet e auditimit...! Pastaj, në fq. 28 lidhur me publikimin e analizës së zgjedhjeve nga KQZ: formulimi i paragrafit që fletë mbi këtë...

Ai, bëri vërejtje edhe në fq. 36 rreth “subvencioneve dhe transfereve”, si dhe te “rekomandimet” – te paragrafi “financimi i partive politike”...

Lidhur me raportin, diskutuan edhe: Sami Hamiti, Arianit Elshani, Eshref Vishi që tha se në të kaluarën raport i punës, madje është shqyrtuar edhe në një punëtori. Kohë ka pasë, se di pse nuk është thirrë takim që ta shohim, ta përmirësojmë, ta korigjojmë...

Në fund, u kërkuar që të punohet gjatë ditës, dhe pastaj raporti të dërgohet në Kuvend.

2.Shqyrtimi dhe miratimi i specifikimeve teknike për shtypjen e fletëvotimeve dhe broshurave për Zgjedhjet Lokale 2021:

Alim Rama: Në KOZ, kemi shqyrtuar specifikat teknike për shtypjen e fletëvotimeve dhe broshurave për Zgjedhjet Lokale 2021, dhe me kërkesë që të vazhdohet me përmirësimin dhe plotësimin e vërejtjeve dhe sugjerimeve tona, ne rekomandojmë të miratohen.

Në këtë pikë, diskutoi edhe Sami Hamiti.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim të KOZ-it.

Këshilli për Buxhet dhe Financa

1.Shqyrtim dhe miratimi i kërkesës për transfer në programin e zgjedhjeve nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në shpenzime komunale:

Sami Hamiti: I kemi shqyrtuar në takim dy pika. Pra, e kemi këtë kërkesë për transfer në programin e zgjedhjeve nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në shpenzime komunale. Kjo, ndërlidhet me shpenzimet të cilat kanë ndodhur në bazë të vendimit të KQZ. Është shpenzim që ka ndodh, dhe mjetet janë... Kërkesa është për 14 000 euro...

Z. Hamiti, shpjegoi mënyrën dhe procedurat se, s'i bëhet kjo pagesë që tha se, është krejtësisht e ligjshme...

Miratohet me vota unanime...

2.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për ndarje të re buxhetore -buxhet shtesë në Program të Zgjedhjeve – në kategorinë e shpenzimeve kapitale për souftverin e QNR-së për Zgjedhjet Lokale 2021:

Sami Hamiti: Serveri, është gjithësi i nevojshëm. E kemi trajtue, e kemi analizue... Ky projekt, duhet të bëhet dhe, pavarësisht se a na lejohet apo jo, duhet të gjejmë mundësi. Na është kërkuar një kërkesë shtesë, ky është një investim kapital...Por, ne duhet të shohim edhe në bashkëpunim me OSBE...

Ky projekt, është nevojë imediate! Kjo, s'duhet të vonohet sepse, sipas procedurave na duhen 3 muaj, prandaj filloni në Sekretariat...

Në këtë pikë, diskutuan edhe: Eshref Vishi, Alim Rama, Arianit Elshani dhe Burim Ahmetaj.

5.Të ndryshme!

Në të ndryshme, Arianit Elshani propozoi që KQZ – së së Shqipërisë, ti dërgohet një letër-falënderimi për pritjen dhe bashkëpunimin...